



Projektet e realizuara të Forumit të Gruas-Tetovë

2001-2018

FORUMI I GRUAS • WOMEN'S FORUM • ЖЕНСКИ ФОРУМ

Shoqata Forumi i Gruas -Tetovë është një shoqatë e pavarur, joqeveritare dhe jopartiake e themeluar në janar të vitit 2001. Aktivitetet e Shoqatës fokusohen në ngritjen e vetëdijes dhe avokimit për barazinë gjinore, si dhe dhënien e informacionit, ndihmës, mbështetjes dhe mbrojtjes së grave dhe pozitës së tyre në shoqëri. Shoqata Forumi i Gruas gjendet në Tetovë dhe realizon aktivitetet e saj në të gjithë rajonin verior dhe atë perëndimor të Maqedonisë.

Shoqata ka 40 anëtarë të cilët janë aktivisht të përfshirë në aktivitetet e saj. Anëtarët posedojnë njohuri, shkathtësi dhe përvojë në çështjet gjinore dhe barazinë gjinore. Ata janë të ndjeshëm në trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për gratë dhe fëmijët, veçanërisht për personat e prekshëm. Duke inkurajuar kontributin e komuniteteve lokale, Shoqata mobilizon vullnetarët që janë aktivisht të përfshirë në veprimet e Shoqatës. Në këtë mënyrë, komunitetet janë të përfshira në përmirësimin e jetës së tyre, duke kontribuar në zhvillimin e një shoqërie humane dhe demokratike.

Vizioni

Forum i Gruas - Tetovë i sheh gratë plotësisht të ndërgjegjshme, të lira nga normat dhe paragjykimet tradicionale dhe patriarkale, të fuqëzuara ekonomikisht, të barabarta në raporte gjinore dhe të integruar në shoqëri.

Misioni

Forum i Grave - Tetovë punon me gra të ndryshme, veçanërisht me gratë nga zonat rurale, duke u dhënë atyre inkurajim dhe ndihmë, duke mbështetur fuqëzimin e tyre përmes informimit, edukimit dhe avokimit për të drejtat, nevojat dhe interesat e tyre.

Sipas planit strategjik, qëllimet dhe programet strategjike të Shoqatës janë:.

1. Përmirësimi i kushteve për pavarësinë ekonomike të grave
2. Modeli i mbrojtjes së integruar të të mbijetuarve të dhunës në familje në rajonin e Pollogut
3. Përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, posaçërisht të grave
4. Zhvillimi institucional i Forumit të Grave (forcimi i kapaciteteve të veta)

1. Projekti: Zhvillimi i hershëm fëmijëror

Vendi: Tetovë, Shkup, Gostivar, Kumanovë,

Grupi qëllimor: nëna dhe fëmijë

Aktiviteti: Edukimi

Periudha kohore: 2001/2005

Finansuar: UNICEF

Objektiva kryesore e Projektit: të promovojë integrimin social të fëmijëve parashkollor prej 1 - 6 vjeç fëmijë që u takojnë komunitete të marginalizuara rurale, rurale malore dhe suburbane të cilët nuk kanë mundësi për edukim parashkollor. Në këtë mënyrë përfshihen një numër i konsiderueshëm i fëmijëve në edukim të hershëm intelektual, që vlerësohet si fazë parapregatitëse për shkollim.

2. Projekti: Shkrim-lexim

Vendi: Tetovë, Gostivar, Shkup, Kumanovë

Grupi qëllimor: gra dhe vajza

Aktiviteti: Edukim

Periudha kohore: 2001/2005

Finansuar: Unicef

Qëllimi i projektit është tu ndihmohet grave në arritjen e aftësive dhe diturive të nevojshme në jetën e përditshme.

3. Projekti: Edukimi shëndetësor

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Gratë dhe vajza të reja

Aktiviteti: Edukimi, organizimi i puntorive, shtypja dhe distribuimi i broshurës informative.

Periudha kohore: 2002

Finansuar: ARC

Qëllimi kryesor i projektit ishte ngritja e nivelit të edukimit shëndetësor në këto fshatra si dhe ofrimi i përkrahjes psikosociale të personave të traumatizuar nga konflikti i armatosur.

4. Projekti: E drejta e gruas të vendos

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: gratë

Aktiviteti: Edukim

Periudha kohore: 2002

Finansuar: Karitas

Qëllimi kryesor i projektit është vetëdijësimi i femrave për të drejtën e tyre për të vendosur si dhe aftësimi i tyre për pjesmarje në procesin e votimit.

5. Projekti: Bashkëpunimi ndëretnik kulturor

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Gratë dhe të rinjtë

Aktiviteti: Bashkëpunimi kulturor ndërmjet etniteteve

Periudha kohore: 5 (04.15.2002-08.31.2002)

Finansuar: IOM , USAID

Projekti për qëllim ka zbutjen e marrëdhënieve të acaruar ndërmjet dy etniteteve në R. e Maqedonisë.

6. Projekti: Kthimi i besimit

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: gratë të etniteteve të ndryshme

Aktiviteti: organizimi i tribunave në vendet rurale dhe urbane të qytetit me temë: „Kthimi i besimit në regjionin ku jetojmë„.

Periudha: 6 muaj
2003

Finansuar: ECMI

Qëllimi i projektit: ngritja e nivelit të tolerancës dhe besimit ndëretnik si dhe promovimin e kulturave të etniteteve në rethin tonë si pasuri shoqërore dhe piknisje për relaksim të raporteve ndëretnike.

7. Projekti: Qendra për ndihmë juridike

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Qytetarë

Aktiviteti: Dhënia e ndihmës juridike

Periudha kohore: 09.2003-2009

Finansuar: ESE-Shkup

Qëllimi i projektit është dhënia e ndihmës juridike femrës e cila është viktimë e dhunës familjare pa marrë parasysh përkatësinë e saj nacionale, moshën apo religjionin dhe atë e tëra kjo bëhet pa kompenzim materijal

8. Projekti: Trafikimi me njerëz është krim

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Të rinjtë

Bashkëpunim: Komuna e Tetovës

Aktiviteti: Edukimi dhe distribuimi i materijalit informativ

Periudha kohore: 3 muaj 2004

Finansuar: IOM

Qëllimi i projektit: që të informohen të rinjtë me dukurinë e trafikimit me njerëz dhe mënyrat se si të mbrohen nga kjo dukuri.

9. Projekti: Të rinjtë në milenuimin e ri

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: të rinjtë nga të gjitha etnitete të rajonit të Tetovës

Aktivitetet: organizimi i puntorive me lojra rekreative për fëmijë të moshave të ndryshme nga etnitet që jetojnë në qytetin e Tetovës.

Peridha kohore: viti 2004

Finansuar nga : Qendra e Gruas Dibër

Qëllimi i projektit: që tu ofrohet fëmijëve bashkëpunim ndërmjet etnive për ti thyer barrierat që kanë egzistuar, dhe për të paraqitur anën rekreative të tyre nëpërmjet lojave të ndryshme.

10. Grua më e fortë në shoqëri të shëndoshë

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Qytetarët dhe gratë

Aktivitetet: Distribrimi i broshurës në tri gjuhë: gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke me moton “luftë kundër trafikimit me njerëz”, dhe organizimi i kampanjës në ditën e gruas “ 8 Marsin” me moton “në shoqëri të shëndoshë grua e fortë”.

Periudha kohore: viti 2004

Finansuar nga: OSBE, IOM dhe Komuna e Tetovës

Qëllimi i projektit: Qëllimi kryesor i projektit është vetëdijësimi i femrave për të drejtën e tyre për të vendosur si dhe aftësimi i tyre për pjesmarje në çdo sferë të shoqërisë.

11. Projekt: Promovim i broshurës “Stop Armëve”

Vendi: Komuna e Tetovës

Grupi qëllimor: qytetarët dhe të rinjtë

Periudha kohore: viti 2004

Aktivitetet: Promovimi dhe distribuimi i broshurës “stop Armëve” në vendet të caktuara të komunës të Tetovës dhe mbajtja e tribunës po në këtë temë në hapsirat e komunës të Tetovës.

Partnerë: OJQ AGTIS-Prilep

Finansuar nga: SOROS

Qëllimi i projektit: Të zvoglohen incidentet gjatë përdorimit të armëve të lehta dhe dhuna në komunën e Tetovës.

12. Projekti: Promovimi i broshurës “Stop Korupsionit”

Vendi: Tetovë dhe Shkup

Grup qëllimor: antarë nga institucionet dhe qytetarë

Periudha kohore: viti 2004

Aktivitetet: promovim i broshurës në komunën e Tetovës dhe komunën e qytetit të

Shkupit dhe mbajtja e tribunës me temën “lufta kundër korupcionit”.

Partnerë: OJQ AGTIS-Prilep

Finansuar nga: SOROS-Shkup

Qëllimi i projektit: të zvoglohen rastet e korupcionit në institucionet shtetërore, dhe ngritja e vetëdijes tek qytetarët për pasojat e korupcionit në shoqëri

13. Projekti: Tetova kundër trafikimit me njerëz

Vendi: Tetova dhe regjioni

Grupi qëllimor: Të rinjtë

Aktiviteti: Dhënija e filmit Lilja-4ever

Periudha kohore: 11-12.2004

Finansuar: OSBE

Qëllimi i projektit është që të rinjtë të informohen me problemin e trafikimit me njerëz dhe mënyrat se si të mbrohen nga kjo dukuri.

14. Projekti: Nevojat dhe mundësitë për ndërmarrësi

Vendi: Tetova dhe regjioni

Grupi qëllimor: Gratë

Aktiviteti: Punëtori

Organizata partner: Jeta e lumtur

Periudha kohore: 11-12.2004

Finansuar: SOROS

Qëllimi i projektit është motivimi i femrave për ndërmarrësi përmes hulumtimit të nevojave dhe mundësive me të cilat disponon qyteti i Tetovës.

15. Projekti: Kontribut për ruajtjen e vlerave folklorike të etniteteve në rajonin e Tetovës

Vendi: Tetova dhe regjioni

Grupi qëllimor: Gratë

Aktiviteti: Punëtori

Organizata partner: Muzeumi i Tetovës dhe Organizata e grave të f. Jegunovcë

Periudha kohore: 11.2004-12.2005

Finansuar: Ambasada Hollandeze

Qëllimi i projektit është ruajtja e vlerave tradicionale folklorike, përmbajtja e grave nga vendet rurale për tu dhënë mundësi për forcim ekonomik, pasurim i koleksionit të muzeut të Tetovës dhe promovimi i vlerave folklorike të etniteteve të ndryshme.

16. Projekti: Zhvillimi social në nivel regjional

Vendi: Tetovë, Tearcë, Çair dhe Likovë

Grupi qëllimor: gratë, fëmijët, dhe të rinjtë

Aktiviteti: Edukim

Periudha kohore: 2005

Finansuar: UNICEF

Objektivat e projektit janë të mobilizohen dhe mbështeten bashkësitë lokale në ngritjen e kapacitetit për zhvillimin e komunave të tyre, të përmisohen mundësitë për fëmijët, grate dhe familjet që të kenë qasje të lirë ndaj shërbimeve sociale.

17. Projekti: Planifikimi strategjik i organizatës

Vendi: Ohër

Periudha kohore: viti 2005

Grupi qëllimor: antarë të FGSH-së

Aktivitet: organizimi i seminarit dyditor në Ohër për planifikimin strategjik të organizatës ku morën pjesë një numër i madh i organizatave joqeveritare nga qyteti i Tetovës.

Finansuar nga: OSBE

Qëllimi i projektit: të zhvillohet kapaciteti i organizatës dhe organizata të posedojë planifikim strategjik për aktivitetet e saja deri më vitin 2009.

18. Projekti: Kampanja Nacionale kundër trafikimit me njerëz

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Të rinjtë

Aktiviteti: Dhënia e filmit "Ti je gjallë", mbajtja e tribunës dhe distribuimi i materialit informativ.

Periudha kohore: 2005

Finansuar: La Strada dhe CRS

Qëllimi i kampanjës është ngritja e vetëdijes tek të rinjtë për prezencën e dukurisë së tregtimit me njerëz në regjionin e Tetovës.

19. Projekti: Program për stabilizimit ekonomik dhe social për viktimat potencial të trafikimit në regjionet kufitare të R. së Maqedonisë.

Vendi: Tetova dhe regjioni

Grupi qëllimor: Gratë dhe vajzat të moshës prej 18-30 vjeç.

Aktiviteti: trajnimi i grave për njohuri të biznesit dhe ndjekja e kurseve paraprake për punësim të 18 grave të kyçura në projekt.

Periudha kohore: 10.2005-12.2006

Finansuar: IOM dhe Qeveria Norvegjeze

Objektivat e programit-të promovohet punësimi i femrave dhe të rriten mundësitë për të krijuar të ardhura nëpërmjet ndihmës së mikrokredive

20. Projekti: Kampanja informative kundër trafikimit me njerëz në nivel regjional

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Të rinjtë

Aktivitete: Ngjitja e plakateve me logon “mos i mbyll sytë para trafikimit me njerëz”, distribuimi i materialit informativ me të njëjtën logo (kësula, maica, lidhëse për mobila etj), pjesmarja në debatet televizive në televizionet lokale në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Periudha kohore: 04 - 05.2006

Finansuar: IOM dhe Qeveria e Finlandës

Qëllimi: Ngritja e vetëdijes dhe informimi tek të rinjtë për praninë dhe reziqet nga paraqitja e dukurisë të trafikimit me njerëz nëpërmjet kampanjës informative.

21. Zhvillimi i kapaciteteve të koalicioneve lokale për luftën kundër trafikimit me njerëz

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: anëtarët e koalicionit të Tetovës për luftë kundër trafikimit me njerëz

Aktivitete: Puntori për formimin e koalicionit dhe vërtetimi i prioriteteve të aktiviteteve, puntori për përtforcimin e kapaciteteve për formimin e Koalicionit dhe nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim.

Periudha kohore: 2006

Bartës: GIEM “Semper” manastir

Donator: OSBE

Qëllimi: Formimi i koalicionit të Tetovës për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe përtforcimi i kapaciteteve për luftë më efektive kundër dukurisë së trafikimit me njerëz në komunën e Tetovës.

22. Projekti: Partneritet për shoqëri të sigurta

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Të rinjtë dhe qytetarët

Aktivitete: Distribuimi i plakateve dhe broshurave me moto “Stop Armët” në shkollat e mesme të qytetit, dhe dy Univerzitetet në Tetovë.

Periudha kohore: viti 2006

Finansuar nga : UNDP dhe komuna e Tetovës

Qëllimi: Të zvoglohen incidentet gjatë përdorimit të armëve të lehta dhe dhuna në komunën e Tetovës si dhe nëpërmjet kampanjës informative dhe edukimit të rritet vetëdija tek qytetarët për reziqet e posedimit dhe përdorimit të armëve.

23. Projekt : tradita/inovim-Identiteti kulturor i zanateve maqedonase

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Qytetarët

Aktivitetet: Përpunimi i veshjeve shiptare tradicionale; punime nga leshi, ottoman, jastuk dheqlyma dhe çorape për krishtlindje të punuara nga sërma dhe ruaza.

Periudha kohore: 2006

Bartës: MATA-Asocijacioni tregtar të artizanateve maqedonase

Donator: Ministria për punë të jashtme e Mbretërisë Norvegjeze

Qëllimi: Të rritet interesi për trashigimi kulturore, rruajtja e vlerave tradicionale si burim i inovimit dhe funksionimi i veshjeve tradicionale për përdorimin e tyre, përmisimi i bashkëjetesës dhe përmisimi i standardit jetësor, zhvillimi i identitetit nacional në Maqedoni me ndihmën e marketingut aktivitetëve në vend dhe jashtë vendit.

24. Projekt: Sektori i Zanateve maqedonase-Qëndrueshmërija dhe mirëbesimi me anë të lidhjeve të pazareve”

Vendi: Tetovë

Aktivitetet: Zhvillimi i produkteve dhe dizajn, marketingut (lokal dhe internacional); trajnim biznesi dhe puntoritë edukative-produktive (prodhimi i jastuqeve dhe qylimave nga leshi)

Periudha kohore: 2007

Bartës: MATA-Asocijacioni tregtar i artizantave në Maqedoni

Donator: Ministria për punë të jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë

Qëllimi: Rritja e mundësive për përfitim nga zanatete, Përmisimi i raporteve ndëretnike, rritja e interesit për trashigiminë kulturore, përcjellja e njohurive tek gjeneratat e reja, promovimi i identitetit nacional në pazarin botëror.

25. Projekt: Programi për zhvillim të kapaciteteve të organizatave

Vendi: Tetovë dhe Kumanovë

Grupi qëllimor: OJQ lokale të cilat kanë nevojë për zhvillim të kapaciteteve të tyre

Aktivitetet: trajnime për planifikim strategjik planifikim strategjik (dy faza), udhëheqje me cikël projektet, bashkëpunim me vetqeverisjen lokale, dhe puntori për përgaditjen e buxhetit, monitoring dhe evaluim, puna administrative etj.

Periudha kohore: 2006-2007,

Donator: OSBE

Qëllimi: ishte që OJQ- ve t'ju mundësohet zhvillim i kapaciteteve dhe që do t'ju sigurohet vlerësimi i nevojave të organizatës nga konsulentët e MCMS.

26. Puntori në kuadër të kampanjës: “Tejkaloje kancerin-bëhu grua e shëndoshë”

Vendi: Tetovë

Grupi qëllimor: Gratë

Periudha kohore: 10.2007

Aktivitet: puntori edukative

Donator: Ministria për shëndetësi në bashkëpunim me Lobin e grave në Maqedoni si dhe me Komisionin e Kuvendit për Mundësi të Barabarta

Qëllimi: Rritja e vetëdijes tek grua për zbulim të hershëm të kancerit në gji si dhe kontrollat e rregullta të gjirit dhe PAP test.

27. Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm tek fëmijët nga mosha 0-6 vjeç

Vendi: Tetovë dhe fshatrat përreth

Grupi qëllimor: fëmijë të moshës prej 0-6 vjeç dhe prindërit

Aktivitet: Formimi i i fokus grupi me prindërit dhe testimi i instrumenteve për validim në teren, punimi i planit akcional për implementim të Standardeve, trajnime të personalit në çerdhet ne fshatrat përreth.

Periudha kohore: 2007-2008

Partner: çerdhet për fëmijë “Mladost” Tetovë

Qëllimi: Të sigurohet kualitet në shërbimet për zhvillimin e hershëm fëmijëror me anë të Standardeve të cilët i prezantojnë rezultatet e arritura me fëmijët në procesin e mësimin të hershëm.

28. Web faqja e organizatës

Aktivitet: Punimi i Web faqes të organizatës

Donator: GGF-Gemeiden Gemeinsam Freiamt

Periudha kohore: 2008

Qëllimi: Me anë të punimit të ëeb faqes, opinioni më gjërë të njohtohet me vetë organizatën, si dhe të gjitha informatat si: projektet, aktivitetet, programet, raportet vjetore etj.

29. Tolerancë zero për votimin familjar

Vendi: Komuna e Tetovës, komuna e Tearcës, Komuna e Zhelinës

Grupi qëllimor: Gratë dhe vajzat

Aktivitet: distribuimi i materijalit informative

Donator: GGF -Gemeiden Gemeinsam Freiamt

Qëllimi: Të ngritet vetëdija tek gratë nga vendet rurale me shqiptarë nga rajoni i Tetovës për votim të fshehtë që të ndalohet votimi familjar me anë të distribuimit të materijalit informativ.

30. Puntori në kuadër të kampanjën: “Mundemi dhe duhet-Fer zgjedhje 2008”

Vendi: Komuna e Tetovës, Komuna e Teracës dhe Komuna Zhelinës

Grupi qëllimor: Gra dhe vajza të reja

Aktivitet: Organizimi i puntorive edukative

Donator: Ambasada e Mbretërisë Holandeze

Periudha kohore: 05-06.2008

Partner: Lobi i grave të Maqedonisë në bashkëpunim me NDI dhe Asociacioni qytetar MOST

Qëllimi: Të rritet informimi dhe të ngritet niveli i vetëdijes tek popullata për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave, në vendet rurale ku votimi familjar është më i shpeshtë dhe dënohet me principet demokrate të shoqërisë.

31. Projekt: Dinjitet për gruan votuese

Vendi: Komuna e Tetovës dhe komuna e Tearcës, Komuna e Zhelinës

Grupi qëllimor: Gratë dhe vajzat

Aktivitet: Organizimi i tribunave dhe distribuimi i materijalit informative, pregaditja, shtypja dhe distribuimi i materijalit informativ në formë të posterëve dhe broshurave - pregaditja dhe distribuimi i pyetsorëve për evaluacion.

Periudha kohore: Tetor 2008-Janar 2009

Donator: UNDP

Partner: Komisioni për barazi gjinore të komunës të Tearcës dhe komunës të Zhelinës.

Qëllimi: Të ngritet vetëdija tek gratë në rejonin e Tetovës për votim të fshehtë dhe të ndalohet votimi familjar dhe votimi në emër të dikuj tjetër.

32. Projekt: Buxhetimi sensitiv gjinor në nivel lokal

Vendi: Komuna e Tetovës (qyteti i Tetovës dhe të gjitha fshatrat e kësaj komune)

Grupi qëllimor: 2500 Qytetarë të komunës së Tetovës (gra dhe burra nga vendet urbane dhe rurale)

Aktivitet:

- Përgaditja e pyetsorit për intervist në teren
- Trajnim të 20 intervjuerëve më parë të përzgjedhur
- Intervist me qytetarët në teren
- Përpunimi dhe analizimi i pyetsorëve të plotësuar

Donator: UNIFEM

Periudha kohore: Mars 2009 - Korik 2009

Qëllimi: Sa qytetarët janë të njoftuar dhe të kënaqur me shërbimet që ua ofron Komuna e Tetovës, sa qytetarët kanë njohuri për buxhetimin gjinor në nivel komunal dhe sa janë të kyçur në shërbimet që i ofron komuna e Tetovës

33. Projekt: Puntori për edukim shëndetësor të grave

Vendi: Rajoni i Komunës së Tetovës: Komuna Tetovë, Tearcë, Jegunovcë, Bogovinë, Zhelinë, Bërvenicë, me të cilën do të përfshihen 20 fshatra

Grupi qëllimor: Gratë nga vendet rurale dhe suburbane të cilat i takojnë grupeve të marginalizuara dhe grupeve të pambrojtura

Aktivitet:

- Punëtori edukativo-informative për ngjitjen e vetëdijes të gratë për nevojën e kontroleve të rregullta preventive
- Ligjerata nga ekspert (mjek ,diskutim dhe mundësi për tu parashtruar pyetje dhe shkëmbim mendimesh)
- Distribuem i materialit informativ broshura dhe postera Donator: OSBE

Qëllimi: Të ngritet vetëdija tek gratë për kontrolat e rregullta preventive. Përmirsimi i shëndetit tek gratë dhe zvoglimi i nivelit të vdekshmërisë tek gratë. Ritja e numrit të sëmundjeve të hershme të zbuluara tek gratë sic është kanceri. Tejkalimi i praktikave tradicionale tek gratë për vizita jo të rregullta mjekësore.

34. Projekt: Dalloni dhunën familjare

Vendi: Komuna e Tetovës (qyteti dhe fshati Sellcë), Komuna Jegunovcë (f.Jegunovcë, Shemshovë,Vratnicë) Komuna Zhelinë (f.Zhelinë dhe f. Trebosh)

Grupi qëllimor: Qytetarët

Aktivitet:

- Mbajtja e tribunave në fshatrat e rethinës të Tetovës
- Pregaditja, publikimi dhe distribuimi i materialit informativ Tv debate në gjuhën maqedone dhe gjuhën shqipe
- Formimi i trupit koordinues në nivel lokal për preventivë nga dhuna në familje
- Donator: UNFPA

Qëllimi: Të ngritet vetëdija tek qytetarët në luftë për mbrojtjen e të drejtave të tyre Ngritja e vetbesimit tek gratë dhe inkurajimi i tyre që të paraqesin rastet e dhunës. Rritja e bashkpunimi ndërmjet institucioneve lokale dhe sektorit civil në dhënjen e shërbimeve në rastet e dhunës në familje. Informimi i opinionit më gjërë për shërbimet që i ofron Qendra për ndihmë juridike në Tetovë dhe mënyrat e përfitimit të shërbimeve.

35. Projekt: Trupi koordinues në nivel lokal

Vendi: Komuna e Tetovës (qyteti, f.Veshallë dhe f.Recicë e Madhe) Komuna Jegunovcë (f.Jegunovcë, Rogacevë) Komuna Zhelinës (f.Zhelinë dhe f. Strimnicë) Komuna Tearcë (f.Tearcë dhe f.Nerasht).

Grupi qëllimor: banorët nga rajoni ku implementohet projekti (urban dhe rural) të cilat janë viktima potencial të dhunës në familje dhe opinionit më gjërë.

Lider të Komunave, kryerës të funksioneve publike, lider fetarë dhe OJQ lokale.

Aktivitet:

- Zgjerimi i trupit koordinativ të formuar në nivel lokal për preventivë nga dhuna në familje, takimet të regullta dhe ndjekja e gjendjes.
- Nënshkrimi i memorandumit për bashkpunim me Komunën e Tearcës
- Vlersimi i gjendjes në pjesën e dhunës në familje në të gjitha Komunitat të prekura me projektin me anë të hulumtimit për të vrejtur nivelin isë për dukurinë e dhunës në familje
- Organizimi dhe mbajtja e tribunave informative-edukative në vendet urbane dhe rurale të komunave të përfshira në projekt
- Organizimi dhe mbajtja e forumeve me liderët e Komunave, kryerës të detyrave, lider fetarë të përfshirë në Komunitat e projektit
- Publikim dhe distribuimi i materialit informativ (broshura dhe postera)
- Prezentimi i rezultateve nga aktivitetet e projektit
- Trajnim për mediumet
- Trajnim për OJQ-të

Donator: UNFPA

Periudha kohore: 16 muaj

Qëllimi: ngritja e vetëdijes tek qytetarët për ndryshimin e qëbdrimeve të tyre rreth dhunës në familje (zvoglimi i numrit të viktimave të dhunës në familje dhe preventiva)

Qëllimet specifike të projektit: ngritja e vetëdijes tek qytetarët dhe njohja e tyre me dukurinë e dhunës në familje, ngritja e vetbesimit të qytetarëve dhe të inkurajohen që të paraqesin rastet e dhunës në familje, senzibisimi i liderëve të Komunave kryerës të funksioneve publike, përforcimi i trupit koordinues të formuar dhe intensivi i bashkpunimit ndërmjet institucioneve lokale dhe sektorit civil në dhënien e shërbimeve për rastet e dhunës në familje, informimi i opinionit më gjërë për problemin e dhunës në familje dhe shërbimet që ofron QNJ Tetovë dhe mënyrat e marje së shërbimeve.

36. Projekt: Dera e hapur – ndihmë juridike

Vendi: Komuna e Tetovës, Tearcë, Jegunovcë, Bogovinë

Grupi qëllimor: të gjithë qytetarët të cilët janë viktimat potencial të dhunës në familje. Shfrytëzues primarë janë viktimat e dhunës në familje të cilët janë në pozitë të rëndë ekonomike dhe sociale

Aktivitet:

- Organizimi dhe mbajtja e takimeve direkte me përfaqësues nga njësitë e vetqeverisjes lokale ku implementohen aktivitetet e projektit
- Përgaditja dhe publikimi i materialit informativ për aktualizim e qendrës - pregaditja e formularit fillestarë dhe lista evaluative dhe plotësimi i tyre
- Takimi me OJQ lokale dhe formimi i rjetë sjoformale të cilët ofrojnë ndihmë për viktimat e dhunës në familje
- Distribiumi i materialit informativ
- Përpunimi i ankesave ,propozime,kërkesa dhe të dhëna tjera deri tek

institucionet përkatëse dhe përfaqësimi në Gjykatë nga ana e Avokatit

Donator: UNIFEM

Periudha kohore: nga 15 Prill deri 1 .1. 2011

Qëllimi: të përforcohet gjendja e Qendrës për ndihmë juridike për viktimat e dhunës në familje, në shoqëri si organizat qytetare e cila punon për preventivë dhe mbojtje të viktimave nga dhuna në familje dhe zvoglimi i dhunës si e keqe e shoqërisë. Aktivitete e projektit do të ndihmojnë për përmirsimin e sistemit për ndihmë juridike të viktimave të dhunës në familje me mundësimin për qasje më të madhe të viktimave deri në qendër.

37. Projekti: Mësimi i hershëm dhe Standardet për zhvillim

Vendi: Komuna e Tetovës dhe Komuna e Tearcës

Grupi qëllimor: gra, fëmijë dhe familje rome te marginalizuara nga Tetova dhe Tearca

Aktivitetet:

- Edukim në pajtueshmëri me standardet për zhvillim të hershëm mësimorë të fëmijëve të moshës prej 0-6 vjec të cilët i takojnë vendeve të marginalizuara rurale dhe suburbane, dh të cilët nuk kanë mundësi për edukim parashkollorë, punë me prindërit, ndihmë për nënat për shkrim-lexim dhe rritje të aftësive të tyre për nevojat e jetës së përditshme.

Donatorë: Unicef

Periudha kohore: 02.2011-31.01.2012

Qëllimi i projektit: Sigurimi i mundësive për gratë, fëmijët dhe familjet për qasje më të mirë deri tek shërbimet sociale

Rezultati i arritur: Mundësi dhe qasje të përmisuara ndaj shërbimeve sociale për fëmijët, gratë dhe familjet, direkt të përfshira shtresat më të prekura në regjionin e Tetovës, këshilla për 1200 shfrytëzues, sigurimi i ndihmës juridike për familjet të cilët kanë nevojë për qasje te shërbimet sociale, e realizuar bashkëpunimi direkt me institucionet të cilat ofrojnë shërbime sociale në Tetovë dhe komunar përreth.

38. Projekti: Aktivitete joformale për Zhvillimin e hershëm fëmijëror për fëmijët më pak të prekur

Vendi: Komuna e Tetovës dhe komuna e Tearcës

Grupi qëllimor: gra, fëmijë dhe familje rome te marginalizuara nga Tetova dhe Tearca

Aktivitete: edukim në pajtueshmëri me standardet për zhvillim të hershëm mësimorë të fëmijëve të moshës prej 0-6 vjec të cilët i takojnë vendeve të marginalizuara rurale dhe suburbane, dhe të cilët nuk kanë mundësi për edukim parashkollorë, punë me prindërit, ndihmë për nënat për shkrim-lexim dhe rritje të aftësive të tyre për nevojat e jetës së përditshme.

Donatorë: Unicef

Periudha kohore: 15.02.2012 – 15.01. 2013

Qëllimi i projektit: Sigurimi i mundësive për gratë, fëmijët dhe familjet për qasje më të mirë deri tek shërbimet sociale.

Rezultati i arritur: Mundësi dhe qasje të përmisuara ndaj shërbimeve sociale për fëmijët, gratë dhe familjet, direkt të përfshira shtresat më të prekura në regjionin e Tetovës, këshilla për 1200 shfrytëzues, sigurimi i ndihmës juridike për familjet të cilët kanë nevojë për qasje të shërbimeve sociale, e realizuar bashkëpunimi direkt me institucionet të cilat ofrojnë shërbime sociale në Tetovë dhe komunat përreth.

39. Projekti: Përmirësimi i punësimit të grave nga bashkësitë etnike, nëpërmjet profilimit-vlerësimit, programeve për trajnim dhe këshillave për punë

Vendi: Komuna e Tetovës dhe komuna e Tearcës

Grupi qëllimor: gra nga bashkësitë etnike (Shqiptare) nga Tetova dhe Tearca

Aktivitetet:

- Organizim dhe mbajtje të kurseve trajnuese pa pagesë për: pastrim të shtëpive dhe mbajtje të higjienës, kompjuterë, parukeri, gatim, rrobaqepsi dhe qëndisje.
- Organizim dhe mbajtje të trajnimeve për biznes plan.

Donatorë: Unioni Europian

Partnerë në projekt: Internationaler Bund, Organizata e grave turke Derja, shoqata qytetare IRHOM Topana.

Periudha kohore: Dhjetor 2012-Prill 2014

Qëllimet e projektit: Të trajnohen gratë të papunuara nga bashkësitë etnike, të bisedohet për kycjen e tyre në tregun e punës, të përkrahen gratë për vetëpunësim dhe hapjen e bizneseve të vogla, të ngritet vetëdija për nevojën e punësimit të numrit më të madh të grave.

Rezultati i arritur:

- Qendra dhe trajnime për gra të udhëhequra me sukses, kurse të mbaruara individuale për trajnime profesionale dhe programe për përkrahje educative, rreth 100 gra me sukses i kanë mbaruar trajnimet për biznes plan, 180 gra me sukses kanë marrë pjesë në programin për përkrahje educative, gra të motivuara për kycjen në tregun e punës, aftësi të përmisuara, njohuri dhe aktivitete të organizatave partnere.

40. Projekti: Rritja e qasjes deri tek Zhvillimi I hershëm fëmijëror për fëmijët dhe familjet rome të marginalizuara

Vendi: Komuna e Tetovës

Grupi qëllimor: gra, fëmijë dhe familje rome të marginalizuara nga Komuna e Tetovës

Aktivitetet:

- Aktivitete për prindër më të mirë me qëllim prindërve të sigurohen informatat e nevojshme për karakteristikat dhe etapet për zhvillimin e fëmijëve dhe mënyrat se si të stimulohet zhvillimi i hershëm për fëmijët nga mosha 0-3 vjeçare.

- Edukim në pajtueshmëri me Standardet për zhvillim të hershëm fëmijëror të moshë prej 0-6 vjecare të cilët I përkasin vendeve të margjinalizuara, rurale dhe suburbane, dhe të cilët nuk kanë mundësi për edukim parashkollorë.
- Ndhimë nënëave për shkrim-lexim dhe rritje të aftësive dhe njohurive të tyre për nevojat e jetës së përditshme.
- Lobim deri tek bashkësitë locale dhe komunat për hapjen e Qendrave të reja për zhvillim fëmijëror dhe mbështetja e tyre financiare për qendrat egzistuese të ZHHF.

Periudha kohore: Dhjetor 2013 në vazhdimësi

Donator: Unicef

Qëllimi i projektit: Të përkrahë bashkësitë rurale dhe të margjinalizuara në komunën e Tetovës në organizim të qendrave për zhvillim të hershëm fëmijëror të përkrahura nga Komuna.

Rezultati i arritur:

- Rritja e numrit të shërbimeve për zhvillim të hershëm fëmijëror dhe qendra të hapura në vendet e margjinalizuara rurale të hapura nga komunat dhe firmat private.
- Përkrahje të bashkësive lokale në vendosjen e praktikave për mobilizim social të bashkësive me qëllim të identifikimit të grupeve më të prekura të fëmijëve dhe familjeve.
- Përkrahje të bashkësive locale në organizim të aktiviteteve lidhur me ZHHF
- Përkrahje të bashkësive locale në lehtësimin e qasjes ndaj shërbimeve primare (shëndetësi, arsim, mbrojtje sociale) nëpërmjet vendosjes së mehanizmave për bashkëpunim me institucionet
- Përdorimin e Standardeve për zhvillim të hershëm fëmijëror si bazë në implementimin e aktiviteteve me fëmijët dhe monitoring të arritjes së tyre.

41. Emri i projektit: Aksion qytetar për barazi gjinore

Vendi: Komuna e Tetovës

